

**UDHËZIM**  
**Nr. 26, datë 5.12.2023**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 30, DATË 4.11.2022, TË  
MINISTRIT TË ARSIMIT DHE SPORTIT, “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE  
DHE AFATEVE TË APLIKIMIT, SI DHE TË PROCEDURAVE TË PËRCAKTIMIT TË  
MASËS DHE MËNYRËS SË FINANCIMIT TË STUDENTËVE TË SHKËLQYER DHE  
ATYRE QË NDJEKIN PROGRAME STUDIUMI QË PËRBËJNË PRIORITET  
KOMBËTAR”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të pikës 6, të vendimit nr. 386, datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

Në udhëzimin nr. 30, datë 4.11.2022, të bëhen ndryshimet, si dhe shtesat më poshtë:

1. Kudo në përmbajtje, ku referohet vendimi nr. 386, datë 1.6.2022, i Këshillit të Ministrave, në fund të shtohet fjala “i ndryshuar”.

2. Pika 1, ndryshon si më poshtë:

“1. Studentët, shtetas shqiptarë, që regjistrohen në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2023–2024, e në vijim, aplikojnë për mbështetje financiare sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 386, datë 1.6.2022, të ndryshuar, pranë Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL), brenda dy muajve nga data e shpalljes së njoftimit për aplikim.”.

3. Shkronja “c”, e pikës 2 ndryshon si më poshtë:

“c) Studenti, i cili ka zgjedhur të ndjekë një prej programeve të studimit, që përbën prioritet kombëtar.”.

4. Pas pikës 2, shtohet pika 2/1 me përmbajtje si më poshtë:

“2/1 Shpërndarja e kuotave për mbështetjen financiare bëhet nga strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe i njoftohet çdo institucioni publik të arsimit të lartë. Institucionet publike të arsimit të lartë, pas marrjes dijeni për përcaktimin e kuotave, i shpërndajnë ato me vendim të Senatit Akademik, sipas përcaktimeve të pikës 6.1, të vendimit nr. 386, datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.”.

5. Pika 3, ndryshon si më poshtë:

“3. Studentët aplikojnë duke depozituar formularin për aplikim.”.

6. Pika 5 ndryshon si më poshtë:

“5. Përzgjedhja e studentëve përfitues sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 2, të këtij udhëzimi, bëhet sipas përcaktimeve në vendimin nr. 386, datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar. Vendimi i Senatit Akademik për përzgjedhjen e studentëve përfitues, në programet prioritare të studimit, i njoftohet Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë.

Pas marrjes së vendimeve të Senateve Akademike të IAL-ve publike, AKFAL-i harton listën përfundimtare dhe ia përcjell ministrisë përgjegjëse për arsimin. Bazuar në këtë listë, ministria përgjegjëse për arsimin akordon fondin për çdo institucion publik të arsimit të lartë.”.

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme për Zhvillimin e Arsimit dhe Sportit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT**  
**Ogerta Manastirliu**